



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA E TIRANËS

**Drejtuar:** Operatorin ekonomik “Edonil Konstruksion” shpk

**Adresa:** Tiranë, Rruga Mihal Popi, Pallati Nr. 4, Kati I

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**  
**(PAS PROCESIT TË ANKIMIT)**

**Procedura e prokurimit:** “Procedurë e Hapur”, me Marreveshje Kuader, **Loti I:** “Përforcim me pilota në objektin 6 kate ekzistues Vllaznia 4”

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** Qëllimi i kontratës është: “Përforcim me pilota në objektin 6 kate ekzistues Vllaznia 4”.

**2. Numri i referencës së procedurës/lotit: REF: 42146-09-19-2022**

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

**Fondi limit per Lotin I: “Përforcim me pilota në objektin 6 kate ekzistues Vllaznia 4”** është **13,404,150** (trembëdhjetë milion e katërqind e katër mijë e njëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

**Burimi i financimit:** me burim financimi Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve te ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit”, miratuar me VKB Nr. 49, datë 14.06.2022 “Për disa ndryshime në VKB Nr. 166, datë 24.12.2021 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2022-2024 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2022 (e ndryshuar)”

**Kohëzgjatja e kontratës:** eshte 8 (tetë) javë kalendarike duke nisur nga data e lidhjes së kontratës;

**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 05.10.2022, ora 10:00**

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 131 datë 26.09.2022.

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. Operatori ekonomik “INERTI” shpk** **NUIS J66926804L**

Vlera e ofertës = **12,721,650** (dymbëdhjetë milion e shtatëqind e njëzet e një mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

**2. Operatori ekonomik “Edonil Konstruksion” shpk** **NUIS K11519006K**

Vlera e ofertës = **12,776,230** (dymbëdhjetë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e tridhjetë) lekë pa TVSH.

**3. Operatori ekonomik “KLAJGER KONSTRUKSION” shpk** **NUIS K51423028P**

Vlera e ofertës = **11,917,800** (njëmbëdhjetë milion e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e tetëqind) lekë pa TVSH.

*Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm përkatësisht për arsyet e mëposhtme:*

**1. Operatori ekonomik “KLAJGER KONSTRUKSION” shpk**

Operatori ekonomik “KLAJGER KONSTRUKSION” shpk nuk permbush kerkesat e percaktuara ne VKM Nr. 285 datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 26, pika 6, ku percaktohet se: *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ftoi operatorin ekonomik “KLAJGER KONSTRUKSION” Shpk, që të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, dokumentat provuese për vetdeklarimet e bëra në Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit si dhe dokumentat e paraqitura në rrugë elektronike brenda datës 28.10.2022. Në rast se Operatori ekonomik, nuk do të pajtohet me këtë kërkesë, ose nuk do të dorëzojë dokumentacionin e kerkuar si me lart, oferta Tij do të refuzohet.

KVO konstatoi se Operatori ekonomik nuk është pajtuar me kërkesën e Autoritetit Kontraktor, pasi brenda datës 28.10.2022, nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kerkuar.

Për sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në mbështetje të Nenit 92, pika 3 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe të Kreut X, Nenit 82, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vendosi të s’kualifikojë ofertën e operatorit ekonomik “KLAJGER KONSTRUKSION” Shpk.

## 2. Operatori ekonomik “INERTI” shpk

Operatori ekonomik “INERTI” shpk nuk permbush kerkesat e percaktuara ne VKM Nr. 285 datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 26, pika 6, ku percaktohet se: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ftoi operatorin ekonomik “INERTI” Shpk, që të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, dokumentat provuese për vetdeklarimet e bëra në Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit si dhe dokumentat e paraqitura në rrugë elektronike brenda datës 01.11.2022.

Në rast se Operatori ekonomik, nuk do të pajtohet me këtë kërkesë, ose nuk do të dorëzojë dokumentacionin e kerkuar si me lart, oferta Tij do të refuzohet.

KVO konstatoi se Operatori ekonomik nuk është pajtuar me kërkesën e Autoritetit Kontraktor, pasi brenda datës 01.11.2022, nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kerkuar. Për sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në mbështetje të Nenit 92, pika 3 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe të Kreut X, Neni 82, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vendosi të s’kualifikojë ofertën e operatorit ekonomik “INERTI” Shpk.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “Edonil Konstruksion” shpk**, me adresë: *Tiranë, Rruga Mihal Popi, Pallati Nr. 4, Kati I*, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **12,776,230** (dymbëdhjetë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e tridhjetë) lekë pa TVSH, është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, me adresë: *Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj), siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesat: Nuk ka pasur.